



Republika e Kosovës – Republic of Kosovo  
Komuna – Municipality



---

04/ 9607 /2024

# DREJTORIA PËR BUXHET DHE FINANCA

## RAPORTI I PUNËS DHE AKTIVITETEVE PËR MUAJIN TETOR 2024

Hani i Elezit, 2024

## DREJTORIA PËR BUXHET DHE FINANCA

Drejtoria për Buxhet dhe Financa për muajin tetor 2024, funksionin e vet e ka ushtruar në bazë të kompetencave dhe përgjegjësiwe ligjore mbi qeverisjen e Komunave të Republikës së Kosovës, Statutin e komunës së Hanit të Elezit, Ligjin mbi menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, Ligjin mbi financat e pushtetit lokal, Ligjin mbi vetëqeverisjen lokale, Ligjin mbi tatimin në pronën e paluajtshme, Rregulloret dhe udhëzimet administrative nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT).

Drejtoria për Buxhet dhe Financa me qëllim të realizimit sa më efikas të të gjitha kompetencave dhe përgjegjësiwe, ka funksionuar kryesisht në katër (4) sektorë:

1. Sektori për buxhet
2. Sektori për financa,
3. Sektori për të hyra dhe
4. Sektori i tatimit në pronë.

Drejtoria për Buxhet dhe Financa e menaxhuar nga drejtoresha e drejtorisë dhe me një staf prej (7) zyrtarëve, gjatë muajit tetor kishte një angazhim permanent, me një përkushtim të madh në drejtim të realizimit sa më të suksesshëm të të gjitha objektivave dhe detyrave të parashikuara në planin e punës së drejtorisë. Aktiviteti i drejtorisë ka qenë i përqëndruar në realizimin e buxhetit sipas dinamikës së planifikuar dhe menaxhimin sa më efikas të buxhetit.

Buxheti i komunës së Hanit të Elezit i ndarë sipas Ligjit me Nr. 08/L-260 mbi ndarjet buxhetore të Republikës së Kosovës për vitin 2024 është në lartësi prej **3,349,278.00 Euro**.

Ky buxhet është ndarë sipas kategorive ekonomike si në vijim:

- Paga dhe shtesa.....2,075,272.00 €,
- Mallra dhe shërbime.....524,500.00€,
- Shpenzimet komunale .....93,500.00€,
- Subvencione dhe transfere ...113,000.00 €,
- Shpenzime kapitale .....543,006.00 €,
- Totali i buxhetit.....3,349,278.00 €.

Punët dhe aktivitetet të cilat janë zhvilluar gjatë këtij muaji, mund t'i veçojmë këto:

### **SEKTORI PËR BUXHET DHE FINANCA**

- Përgatitja e raportit mujor të të hyrave dhe shpenzimeve të muajit shtator 2024 dhe publikimi në ueb faqen e Komunës,
- Përgatitja e raportit të punës dhe aktiviteteve të Drejtorisë Buxhet dhe Financa për muajin shtator 2024 dhe dorëzimi i të njëjtit në Kabinetin e Kryetarit si dhe publikimi në ueb faqen e Komunës në formatin PDF dhe Word,
- Deklarimi në Thesar obligimet e pa paguara dhe ato kontraktuale të muajit shtator 2024,
- Barazimi me Thesar për muajin shtator 2024,
- Përgatitja dhe publikimi i borxhit publik për muajin shtator në ueb faqe të Komunës,
- Hartimi i Raportit të Dëgjimeve Buxhetore për Buxhetin e vitit 2025 dhe parashikimet buxhetore për vitet 2026-2027,
- Publikimi i Raportit të Dëgjimeve Buxhetore për Buxhetin e vitit 2025 dhe parashikimet buxhetore për vitet 2026-2027,
- Dorëzimi i Raportit të Monitorimit të Investimeve Kapitale sipas Periudhave (Q3) në Departamentin e Buxhetit – MFPT,
- Llogaritja dhe realizimi i të gjitha pagesave të destinuar për pagesën e pagave dhe shtesave të Administratës Komunale, të këshilltarëve Komunal, komiteteve të ndryshme të Kuvendit, të Sektorit të Arsimit dhe Sektorit të Kujdesit Primar Shëndetësor.

## RAPORTI I EKZEKUTIMIT TË BUXHETIT PËR MUAJIN TETOR 2024

Kategoritë Buxhetore	Buxheti sipas Ligjit nr. 08/L-260	Buxheti Final	Realizimi Tetor 2024	% e Realizimit Tetor	% Realizimit Janar-Tetor
Paga dhe Shtesa	2,075,272.00	2,075,272.00	169,067.30	8.1%	86.6 %
Mallra dhe Shërbime	524,500.00	609,154.00	58,139.90	9.5 %	65.9 %
Shpenzime Komunale	93,500.00	93,500.00	12,557.94	6.3 %	69.1 %
Subvencione dhe Transfere	113,000.00	372,795.00	256,467.48	68.7 %	95.2 %
Shpenzime Kapitale	543,006.00	793,899.45	0.00	0.0 %	16.6 %
<b>Totali</b>	<b>3,349,278.00</b>	<b>3,944,620.44</b>	<b>496,232.62</b>	<b>12.5 %</b>	<b>69.7 %</b>

### SEKTORI PËR TË HYRAT

Planifikimi i të hyrave vetanake për vitin 2024 është në shumë prej 274,376.00 €.

Në kuadër të këtij sektori janë kryer këto aktivitete:

- Përpunimi, harmonizimi dhe barazimi i evidencave të detajizuara të të gjitha llojet e të hyrave sipas programeve buxhetore, fondeve dhe kodeve ekonomike në Sistemin Informativ të Menaxhimit Financiar të Kosovës (SIMFK),

### SEKTORI I TATIMIT NË PRONË

Gjatë këtij muaji, ky sektor ka pasur këto aktivitete:

- Shërbime të rregullta ndaj qytetarëve.

Drejtoresë e Drejtorisë për Buxhet dhe Financa

Lindita Ballazhi

*L. Ballazhi*

